

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
 Ministry of Finance
 Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo
 ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Njësitë Org.
 Org. Jedin.
 Org. Unit. ZQ

Nr. Prot.
 Br. Prot.
 Prot. No. 09-06-1362

Nr. i faqeve
 Broj stranica
 No. pages: 1

Data
 Datum
 Date: 03.05.2019

PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
 Ministry of Economic Development

Njësitë Org.
 Org. Jedin.
 Org. Unit. 012

Nr. Prot.
 Br. Prot.
 Prot. No. 994

Nr. i faqeve
 Broj stranica
 No. pages: 6

Data
 Datum
 Date: 02.05.19

PRISHTINË/A

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

NDËRMJET

**MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA E
 KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

DHE

ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

PËR

**PROJEKTIN PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË DHE ENERGJISË SË
 RIPËRTËRITSHME NË KOSOVË**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), e cila vepron në emër të Republikës së Kosovës, ka marrë kredi nga Banka Botërore për implementimin e Projektit për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme në Kosovë (PKEEER). Sipas kërkesës së Qeverisë, kredia është paraparë që t'i kontribuojë ngritjes të eficiencës energjetike në ndërtesa të caktuara publike. Projekti përbëhet nga tre komponentë që përfshijnë: (i) investimet në EE dhe BRE në ndërtesa publike; (ii) përkrahje për kornizën politike dhe rregullative për EE dhe BRE si dhe vlerësimin e resurseve të BRE; dhe (iii) përkrahje për implementimin e projektit.

Në këtë projekt, interesat e MZHE-së do të përfaqësohen nga Njësia për Implementim të Projektit (NJIP).

Përmes një procesi të hapur dhe konkurrues, MZHE do të kërkojë propozime (aplikacione) nga Ministritë gjegjëse në tërë vendin dhe do të përzgjedhë kandidatët të suksesshëm që do të marrin pjesë në program.

Programi do të ofrojë financim për projekte të EE (nënprojekte) për ndërtesa publike (p.sh. spitale, ndërtesa universitare dhe ndërtesa tjera të qeverisë qendrore), të cilat rezultojnë me kursime të dëshmuara të energjisë dhe përfitime tjera shoqërore. Në këtë aspekt përfshihen:

- Auditimet e detajuara të energjisë, përfshirë modelet financiare;
- Dizajni teknik;
- Punimet civile/instalimet dhe mallrat dhe pajisjet relevante;
- Mbikëqyrja e punimeve.

Objektet në të cilin do të implementohen masat për EE për vitin 2019/2020 janë : **Administrata Tatimore – Ferizaj, Administrata Tatimore – Gjilan, Administrata Tatimore – Peje, Administrata Tatimore – Gjakove.**

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandum është të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Administratës Tatimore të Kosovës, në lidhje me zbatimin e projektit për Eficiencë të energjisë dhe Energjisë së Ripërtëritshme në Kosovë.

Neni 2 Përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik

1. Përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik përfaqësuar nga AKEE janë si në vijim:

- 1.1. Koordinimi dhe mbikëqyrja e gjithmbarshme e projektit.
- 1.2. Sigurimi i menaxhimit të mirëfilltë si dhe zbatimit transparent të PKEEER.

- 1.3. T'ia përshkruajë procesin dhe procedurat e programit komunave dhe institucioneve pjesëmarrëse.
- 1.4. Të vizitohet ndërtesat që do të rinovohen për të vërtetuar të dhënat themelore, vlerësuar statusin strukturor të ndërtesave dhe vërtetuar përkushtimin e institucioneve për të marrë pjesë në program.
- 1.5. Të menaxhojë këshilltarin e auditimit energjetik dhe procesin përkatës dhe të sigurohet se masat e propozuara janë të realizueshme dhe të pranueshme për përfituesin. Të identifikohen masa tjera jo të ndërlidhura me EE të cilat rekomandohen për të siguruar funksionim efektiv të ndërtesës.
- 1.6. Të diskutojë sferën përfundimtare të punëve të renovimit dhe dizajnet me përfituesin dhe arritja e pajtimit lidhur me masat që do të ndërmerren për EE, si dhe masat që nuk ndërlidhen me EE e të cilat duhet t'i koordinoj vet përfituesi i projektit.
- 1.7. Të kryejë prokurimin e një firme të licencuar dhe kualifikuar, në pajtim me udhëzimet e Bankës Botërore për procedura të prokurimit, për të zhvilluar dizajnin e projektit dhe dokumentet e tenderimit.
- 1.8. Të kryejë prokurimin e një firme të licencuar dhe kualifikuar, në pajtim me udhëzimet e Bankës Botërore për procedura të prokurimit, për të blerë mallrat dhe materialet, ndërtuar projektin dhe aranzhuar komisionimin pas realizimit të projektit.
- 1.9. Sipas nevojës, të aranzhojë mbikëqyrjen e ndërtimit dhe të sigurojë largimin e të gjitha materialeve të rrezikshme në pajtim me ligjet e Kosovës dhe kërkesat e Bankës Botërore.
- 1.10. Të verifikojë realizimin e projektit sipas dizajnit të paracaktuar dhe të vlerësojë kursimet reale të energjisë pas ndërmarrjes së masave të renovimit.
- 1.11. Të sigurojë miratimin përfundimtar të raportit të komisionimit të projektit nga ministrinë e linjës dhe institucionet pjesëmarrëse.
- 1.12. Të ofrojë asistencë teknike për përfaqësuesit e ministrive të linjës në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së nënprojekteve të zbatuara.
- 1.13. Të ofrojë asistencë teknike për përfaqësuesit e ministrive të linjës mbi procesin e organizimit të paraplanifikimit dhe elaborimit të auditimeve të energjisë për ndërtesa të caktuara.
- 1.14. Të mentorojë dhe lehtësojë zbatimin e planeve për kursim të energjisë, të cilët elaborohen me përkrahje nga PKEEER.
- 1.15. Të sigurojë këmbim të vazhdueshëm përvojave mes përfituesve, duke organizuar vizita dhe mundësuar qasje në nënprojekte të zbatuara më parë.

Neni 3

Roli dhe përgjegjësitë e Administratës Tatimore të Kosovës (përfituesit)

1. Përgjegjësitë e Administratës Tatimore të Kosovës (përfituesit):

- 1.1. Organizimi i procesit të promovimit të projektit në nivel lokal dhe të komunitetit.
- 1.2. Monitorimi i përfituesve në kuptim të vonesave kohore dhe fazave të zbatimit.
- 1.3. Emërimi i një personi si pikë kontakti/koordinator i përfituesit për të gjitha fazat e projektit;
- 1.4. Sigurimi dhe lehtësimi i qasjes në hapësirat e veta për personat/subjektet e angazhuar nga MZHE për zbatim të auditimit të energjisë, dizajnim, punime civile dhe mbikëqyrje;
- 1.5. Sigurimi i informatave të domosdoshme/dokumentacionit për MZHE/NJIP dhe kompaninë e kontraktuar gjatë fazave të dizajnit të projektit;
- 1.6. Të pajtohet me MZHE mbi shtrirjen e rinovimit para finalizimit të dizajneve dhe mobilizimit të fondeve, sipas nevojës, për masat komplementare që nuk ndërlidhen me EE, me qëllim që të sigurojë rinovimin e plotë të hapësirave;
- 1.7. Në rast se ndërtesa gjendet në listën e monumenteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës, përfituesi do të paraqesë dizajnin e propozuar për rinovim dhe do të sigurojë të gjitha miratimet dhe lejet e domosdoshme para prokurimit të firmës ndërtimore;
- 1.8. Në bashkëpunim me punëkryesin, të lehtësojë sigurimin e të gjitha lejeve dhe autorizimeve të nevojshme për punime në dizajnim dhe ndërtim;
- 1.9. Të informojë MZHE/NjIP për të gjitha aktivitetet në zhvillim apo të planifikuara (të bëra nga përfituesi apo ndonjë donator tjetër) në ndërtesat e parapara për renovim më projektin e MZHE/PKEEER siq mund të jenë: Ndërtimi I objekteve aneks për përdorim intern, investime në ndërrimin e pjesëve të objektit të cilat lidhen më sferën e punëve të parapara me PKEEER, ndryshimet në menaxhimin e objekteve/ pronësia, shfrytëzimi etj. Përfituesi do ta informojë MZHE-në për të gjitha aktivitetet për këto ndërtesa me qëllim të harmonizimit me projektin e MZHE-së dhe mënjanimi i investimit të dyfishtë.
- 1.10. T'i kontribuojë mbikëqyrjes së punimeve që kryhet nga mbikëqyrësi i pavarur dhe të kontrollojë dhe miratojë deklaratat mbi punimet e kryera;
- 1.11. Të propozojë masa për trajtimin e mëtejshëm të materialeve të padëmshme (dyert, dritaret, radiatorët, etj.) të cilat do të dekomisionohen/largohen;
- 1.12. Të propozojë dhe lehtësojë krijimin e depove të përkohshme për materialet e reja ndërtimore, si dhe materialet e larguara nga godinat;

- 1.13. Të sigurojë se objektet e renovuara janë operative, të mirëmbajë pajisjet sipas nevojës dhe të sigurojë integritetin e pajisjeve dhe mbrojtjen e tyre nga vjedhja, përfshirë këtu edhe ofrimin e stafit/përdoruesit për trajnim për të siguruar funksionimin adekuat të pajisjeve dhe shmangien e tej ngrohjes apo shpenzimit të tepërt të energjisë;
- 1.4. Të sigurojë operim funksional dhe mirëmbajtje të pajisjeve me numër të mjaftueshëm të stafit për operim dhe mirëmbajtje të ndërtesave pasi pranimit dorëzimit të punëve dhe komisionimit të projektit.
- 1.15. Të marrë pjesë në këmbim të përvojave lidhur me zhvillimet e mëparshme në sferën e efijencës së energjisë nën patronatin e AKEE dhe të ofrojë informata të sakta mbi ndikimin e efijencës së energjisë, përfshirë pjesëmarrjen në punëtori për këmbim të përvojave, vizitat në hapësira të Bankës Botërore dhe Qeverisë, aktivitetet mediale, etj.;
- 1.16. Të sigurojë mirëmbajtje të qëndrueshme të projektit.
- 1.17. Të ofrojë asistencë të domosdoshme në përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve të domosdoshme për implementim të nënprojekteve, pa pagesë dhe brenda afateve optimale kohore;
- 1.18. Krijimi i kushteve të nevojshme për organizimin e trajnimeve dhe konkurrimit për përfituesit me performansë më të mire;
- 1.19. T'iu ofrojë përfituesve asistencë në procesin e dorëzimit preliminar dhe përfundimtar të nënprojekteve;
- 1.20. Sigurimi i këmbimit të përvojave në fushën e zhvillimeve të efijencës energjetike në nivel lokal dhe promovimi i përsëritjes së praktikave pozitive;
- 1.21. Dhënia e kontributit për mirëmbajtjen e objekteve të rinovuara dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre; dhe
- 1.22. Pjesëmarrja në hulumtime para dhe pas zbatimit të projektit për të dokumentuar ndikimet e projektit.


Neni 4 **Mosmarrëveshjet**

Palët bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti përmes mirëbesimit ose bisedimeve të përbashkëta. Ndonjë konflikt, kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes, duke përfshirë esencën e saj, vlefshmërinë apo përfundimin, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente në Prishtinë.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.


Arsim Kuliqi


Kryeshf Ekzekutiv i Agjencisë
së Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Prishtinë, datë : 02/05/2019

Ilir Murtezaj


Drejtor i Përgjithshëm

03.05.2019

Administrata Tatimore e Kosovës